



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-004-780	1	31.01.2014



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF
KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/02

Datë: 30.01.2014

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 36 dhe 37, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.01.2014, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

- I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Politikë dhe Financa si komitet të përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.
- II. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52.1, Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit.
- III. Komiteti për Politikë dhe Financa do të ketë përbërjen si në vijim:
 1. Faik Tofaj - Kryesues, subjekti politik AAK
 2. Behare Qestaj - anëtarë, subjekti politik AAK
 3. Xhavit Velijaj - anëtarë, subjekti politik LDK
 4. Bleranda Gacaferi - anëtarë, subjekti politik LVV
 5. Nevruz Krasniqi - anëtarë, subjekti politik PDK
- IV. Komiteti për politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe çdo ndryshim të buxhetit për vitin fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPLA,
- Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
z. Faik Tofaj